

Specialist pranë Sektorit të Monitorimit të Incidenteve Kibernetike, Drejtoria e AL-CSIRT, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, ligjit Nr. 9880, Datë 25.02.2008, "Për Nënshkrimin elektronik", të ndryshuar, VKM-së Nr.141, datë 22.02.2017 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 2 (dy) vende të lira pune në pozicionin:

- **Specialist pranë Sektorit të Monitorimit të Incidenteve Kibernetike, Drejtoria e AL-CSIRT në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Realizon detyrat në përputhje politikat, procedurat dhe udhëzimet e CSIRT Kombëtar;
2. Zbaton në nivel të lartë të gjitha detyrat e caktuara nga eprori dhe argumenton punën profesionale që ka kryer;
3. Merr pjesë në grupin e punës për monitorimin e Infrastrukturat Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit në lidhje me evidentimin e dëmeve dhe mangësive në zbatimin e standardeve teknike;
4. Merr pjesë në ngritjen e sistemeve të sigurisë, në analizat e informacioneve, sistemeve etj, duke propozuar masat mbrojtëse, si dhe mbledh statistikat;
5. Ndhmon në përgatitjen e propozimeve për përmirësime në fushën e legjislacionit për sigurinë kibernetike dhe hartimin e rregullave të sigurisë;
6. Mbledh, monitoron dhe përpunon në mënyre të vazhdueshme informacione për zhvillimet e reja teknologjike, sulmet dhe masat mbrojtëse ndaj tyre;
7. Me autorizim të eprorit bashkëpunon në fushën e sigurisë kibernetike me institucionet e tjera shtetërore, sektorin privat dhe ato ndërkombëtare.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

- Të zotrojnë diplomë të nivelit "Master Profesional" në Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Elektronike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Të ketë aftësi shumë të mira në analizimin dhe zgjidhjen e problemeve në kohë reale;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të bashkëpunimit në grup;
- Përparësi certifikime profesionale në: Certifikata në administrim rrjetash/ Menaxhim sistemesh/IT security/LINUX/Penetration Test; ISO 27001

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (III-b)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 06.03.2023 në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të çertifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.